



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.9954/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Gëzim Llulluni - kryetar i kolegjit, Naim Mehollli dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, A.L. nga fsh. P., Komuna e Gj., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar E. H., avokat nga Gj., sipas autorizimit kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.M. sipas autorizimit, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të ushqimit, vlera e kontestit 702,80€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil, C.nr.1643/2020 i datës 21.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.1643/2020 i datës 21.09.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në pikën I të dispozitivit, ka vendosur që të: APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.L. nga fsh. P., Komuna e Gj. dhe OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 702,80 € dhe atë:

- në emër të shpenzimeve për ushqim për periudhën prej datës 15.09.2018 e deri me datën 11.03.2020 pra për 250 ditë pune, shumën prej 2 € në ditë përkatësisht shumën prej 500,00€ dhe

- në emër të shpenzimeve për udhëtim për periudhën prej datës 15.09.2018 e deri me datën 11.03.2020 për çdo ditë të pranisë së tij në punë, shumën prej 70% nga çmimi i biletës për autobus, përkatësisht për 152 ditë pune në Gjimnazin e Gj., shumën prej 106,40€ ndërkaq për 99 ditë pune në fsh. C., shumën prej 96,40 €. Përkatësisht, për 250 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 202,80 € me kamatë ligjore 8%, duke e llogaritur të njëjtën që nga dita e ushtrimit të padisë, përkatësisht 07.07.2020 deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me të njëjtin aktgjykim, në pikën II, është vendosur që të OBLIGOHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 260,00€ në afat prej 7 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, në atë mënyrë që të prish si të pabazuar aktgjykimin e atakuar, ose të aprovoj ankesën dhe ta prish aktgjykimin dhe ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë në këtë çështje juridike si të pabazuar në ligj, ose ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Pala paditëse nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: paditësi përmes të autorizuarit ka parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurës me datën 07.07.2020 me të cilën padi dhe kërkesëpadi është kërkuar kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit. Paditësi me kontratë pune të përhershme është punësuar tek e paditura respektivisht në SHFMU "N.H." në D., në komunën e Gj., nga data 03.09.2019 deri me datën 11.03.2020, ndërsa në Gjimnazin natyror "Xh.A." në Gj., nga data 15.09.2018 deri me datën 30.06.2019. Pra, gjithsej në këto dy institucione natyrore sipas vërtetimeve të lëshuara nga të njëjtat, paditësi i ka pasur 250 ditë të punës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar kontratën e punës nr.383 të datës 03.09.2019 me konstatimin se paditësi është punësuar tek e paditura përkatësisht SHFMU "N.H." në D., komuna e Gj., ku paditësi A. L. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës mësimdhënës i lëndës së matematikës në shkollën e sipër cekur. Nga kërkesa e paditësit me nr. 05-610/01-0054291/2020 të ushtruar me datën 07.07.2020 është vërtetuar se nga e paditura ka kërkuar pagesën e kompensimit për ushqim dhe udhëtim. Nga lista e pagave në emër të paditësit është vërtetuar se paditësi nuk është anëtar i SBASHK-ut dhe se paga bruto e paditësit është 481,63 € ndërkaq ajo neto është 433,99 € dhe i njëjti ka 2 vite përvojë pune. Me Vërtetimin e SHFMU-së "N.H." në D. është vërtetuar prania në punë e paditësit me gjithsej 152 ditë pune ndërsa në Gjimnazin natyror "Xh.A." në Gj. me gjithsej 98 ditë pune. Me Vërtetimin e datës 02.07.2020 të NSHT-së "B. Trans", operatori B.-Gj., është vërtetuar çmimi i biletës së autobusit në relacion Gj.-P. ka qenë 0.50€ në një drejtim. Ndërkaq me Vërtetimin e datës 02.07.2020 të NSHT-së "Lumi Trans", operatori C.-Gj. është vërtetuar çmimi i biletës 0.70€ në relacion Gj.-C. Ndërkaq, me certifikatë të vendbanimit të lëshuar nga Shërbimi amë në Gj. nr.B10344808 me datë 21.09.2020 dhe në bazë të letërnjoftimit të paditësit ID 0043640 MBP Gj., është vërtetuar vendbanimi i paditësit është në fsh. P., Komuna e Gj..

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat e nenit 35.5 dhe 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës e datës 18.04.2017 , në dispozitat e nenit 90.4 të Ligjit të Punës në relacion me nenin 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, pastaj nenit 382.1 dhe 382.2 të LMD-së si dhe nenit 453 të LPK-së dhe në bazë të nenit 142.1, 142.3 dhe 143.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin e në të cilin arsyetim janë konstatuar edhe faktet me rëndësi vendimtare për një vendosje të tillë. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Prandaj në rastin konkret, pretendimi ankimor në këtë aspekt është i pabazuar dhe njëkohësisht i paqëndrueshëm.

Fakti se paditësi është në marrëdhënie pune në cilësi të mësimdhënësit në SHFMU “N.H.” në D., e konfirmon edhe Kontrata e punës së tij, e bashkangjitur në shkresat e kësaj lënde.

Po ashtu nuk qëndron pretendimi ankimor se paditësi nuk ka ushtruar kërkesë të e paditura për një kompensim të tillë, sepse përfaqësuesi i autorizuar i paditësit E.H. avokat nga Gj., në emër të paditësit i është drejtuar me kërkesë të paditurës, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit për paditësin ku kërkesa e protokolluar nga e paditura mban nr. 05-610/01-0054291/2020 të ushtruar me datën 07.07.2020. Nga e paditura nuk ka pas asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e tillë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk është kontestues fakti se, paditësi për periudhën kohore prej datës 03.09.2019 deri me datën 11.03.2020 ka qenë i pranishëm në vendin e punës në SHFMU-në “N.H.” dhe prej datës 15.09.2018 deri me datën 30.06.2019 ka qenë i pranishëm në vendin e punës në Gjimnazin natyror “Xh. A.”, pra, në tërësi 250 ditë pune. Po ashtu nuk është kontestuese se paditësi për këtë periudhë kohore ka ditë të prezencës së tij në punë me detaje të tjera sikurse me Vërtetimin e SHFMU-së “N. H.” në D. dhe Vërtetimin e Gjimnazit natyror “Xh.A.” në Gj., e për të cilën periudhë kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit - shujtës dhe udhëtimit, duke argumentuar edhe me certifikatën e vendbanimit të tij, e cekur specifikisht si në aktgjykimin e atakuar. Prandaj, nga gjithë kjo rezulton se, gjykata e shkallës së parë, ka marrë aktgjykimin e atakuar pasi që, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore të paditësit, ashtu që pretendimi ankimor në këtë aspekt është i pa bazuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “ Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 4 përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”.

Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Me nenin 35 paragraf 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: “ Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”, ndërsa me paragrafin 7 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Me nenin 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë në relacion me nenin 90.4 të Ligjit të Punës, përcaktohet se “Nëse Kontrata Kolektive pasi t’i skadoi afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 “.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se, në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësve në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata e Apelit vlerëson se e paditura ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, kuptohet për punëtorët të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara me Kontratën kolektive e cila ka qenë në zbatim në kohën e prezencës në vendin e punës të paditësve. Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 përcaktohet se: “*1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut*”, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: “*Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucioneve edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit si dhe të udhëtimit bie mbi të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë se e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive rezulton të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së, me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 9954/2021, me datë 10.10.2022

Kryetari i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Llulluni,